



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT  
ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT  
TË UJËRAVE TË NDOTURA



**V E N D I M**

**Nr. 4, datë 29.02.2012**

**PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORISË SË KONSUMATORVE PËR  
DISA KLIENTË TË VECANTË**

Në zbatim nenit 14 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, për “Kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, Vendimit nr.1304, datë 11.12.2009, për “Miratimin e modelit të rregullores për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizimeve sh.a”, dhe Metodologjisë për Vendosjen e Tarifave, Komisioni Kombëtar Rregullator,

**V E N D O S I:**

1. Të përcaktojë kategorinë e konsumatorve sipas përkatësisë, për disa konsumatorë të vecantë si më poshtë:
  - a. **Trupat diplomatikë** (ambasada, konsullata dhe rezidenca diplomatike) të trajtohen në kategorinë “Ent publik”;
  - b. **Komunitet fetare** (selitë e tyre dhe objektet e kultit si kisha, xhami, etj.) të trajtohen në kategorinë “Ent publik”. Këtu bëjnë përjashtim ato institucione e struktura të krijuara nga këto komunitete të cilat ushtrojnë veprimtari arsimore, shëndetësore e ekonomike, të cilat duhet të trajtohen në kategorinë “Ent privat”;
  - c. **Partitë politike** (selitë dhe degët e tyre në qytete) të trajtohen si “Ent publik”;
  - d. **Shoqëritë tregëtare shtetërore** (KESH sh.a, Ndërmarrjet e Trajtimit të Studentëve, dhe cdo shoqëri tjetër shtetërore) të trajtohen si “Ent privat”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI  
Avni Dervishi**